



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

LIGJ

Nr. 52/2018

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “HEKURUDHAT SHQIPTARE -
REHABILITIMI I LINJËS HEKURUDHORE TIRANË – DURRËS DHE NDËRTIMI
I LINJËS HEKURUDHORE PËR NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR
TË TIRANËS”, NË KUADËR TË GRANTIT TË INVESTIMIT NGA FONDI
I PËRBASHKËT EUROPIAN I BALLKANIT PERËNDIMOR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë – Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, me një grant investimi nga Fondi i Përbashkët European i Ballkanit Perëndimor në shumën 35 435 000 (tridhjetë e pesë milionë e katërqind e tridhjetë e pesë mijë) euro, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 23.7.2018